



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BURREL

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

Nr. 593 Prot, datë 06.06.2012

Nr. 232 Prot, datë 14.06.2012

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DHE
BASHKISË BURREL**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkia Burrel (në vijim të quajtura “Palët”)

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;

Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjitha mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;



Duke konsideruar si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshme të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit dhe barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë;

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i ndryshuar;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “*Memorandumi*”).

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është, bashkërendimi i ndërsjelltë dhe reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Bashkisë Burrel, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:



